



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE AKSIONARE “Klub Futboll Egnatia ”

Sot më 21/08/2020, në Rrogozhinë, u hartua ky akt themelimi nga Aksionaret , Bashkia Rrogozhinë, përfaqësuar nga, Znj. Antonela Dedej, Shoqeria ”Foglia Engineering” S.r.l.; Shoqeria “Demrozi Construzioni” S.r.l, të përfaqësuara me Prokurë të Pergjithshme nr.1151 Rep. dhe nr.501 Kol .nga Agim Demrozi si përfaqësues i Aksionereve,

më poshtë vijon:

Neni 1 Themelimi dhe Emri i Shoqërisë

Krijohet shoqëria aksionare “Klub Futboll Egnatia ” Sh.a . Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me Aktin e Themelimit e Statutin e saj.

Shoqëria e ka selinë e saj në zyrat e saj ne adresen ne Stadiumi “Hasan Zyla”, lagja Nr. 1, rruga e “Kavajes”, Rrogozhinë. Shoqeria eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri aksionare pa Oferte Publike .Shoqëria është e organizuar në formën e shoqërisë aksionare, sipas sistemit me nje nivel, bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 2 Objekti i Shoqërisë


Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit dhe sporteve të tjera. Promovimi, zhvillimi dhe pjesëmarrja në aktivitetet sportive të futbollit të skuadrës së qytetit të Rrogozhinës si në kompeticionet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, pjesmarja në aktivitete të ndryshme sportive kombëtare dhe ndërkombëtare. Veprimet në tregun e lojtarëve për kontraktimin e lojtarëve sipas nevojave të ekipit. Edukimi, stërvitja cilësore dhe përmirësimi atletik e teknik i futbollisteve të rinj duke filluar që nga grup moshat e vogla. Investimet , shërbimet, marketingu me qëllim përmirësimin e imazhit të qytetit dhe të vlerave sportive të Rrogozhinës. Aderimi dhe regjistrimi në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në organizatat sportive ndërkombëtare.

Neni 3 e Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Neni 4 Kapitali Themeltar dhe Aksionet

1. Kapitali i shoqërisë është 3 500 000 (tremilion e pese qindmije), dhe është i ndarë në 100 aksione me vlerë nominale 35.000 (tridhjetë e pese mije) lekë secili.
2. Kapitali i shoqërisë është derdhur, sipas kërkeses se parashikuar ne ligj “Per krijimin e Shoqerive Tregtare”.

- 
3. Të gjitha aksionet e shoqërisë “Klub Futboll Egnatia”, janë aksione të zakonshme. Asambleja e ortakëve, me vendim unanim, mund të vendosë për emetimin e aksioneve të ndryshme nga ato të zakonshmet. Vendimi për emetimin e aksioneve përcakton sasinë e aksioneve si dhe tagrat e tyre.

4. Aksionet zotërohen nga aksioneret si me poshte ;

1. Bashkia Rrogozhine me 25 % te aksioneve, me nr aksionesh 25; me vleren nominale te aksioneve 875.000 lekë.
2. Foglia Engineering S.r.l. me 37.5% te aksioneve, me nr aksionesh 37.5; me vleren nominale te aksioneve 1.312.500 lekë.
3. Demrozi Construzioni S.r.l. me 37.5% te aksioneve, me nr aksionesh 37.5; me vleren nominale te aksioneve 1.312.500 lekë.

Neni 6 Organet drejtuese

Organet e Shoqërisë

1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- a) Asmableja e Përgjithshme
- b) Këshilli Administrimi me nje nivel
- c) Administratori

Neni 7 Përbërja e Këshillit Mbikqyrës

Anëtarë të parë të Këshillit te Administrimit të shoqërisë janë:

1. Idajet Roçi
2. Agron Kalaja
3. Gentian Gjuzi

Ne afat 3 vjecar.

Administratori i pare i shoqerise do te jete

1. Agim Demrozi (me afat 3 vjecar)

2.





Neni 8 Ekspert Kontabël të autorizuar

Auditimi i Shoqërisë do të bëhet nga ekspert kontabël i autorizuar të emëruar nga Asambleja e Aksionerëve.

Ekspert i parë kontabël i autorizuar i Shoqërisë është: Z. Muhamed Kullolli me license nr. 312, me nje afat 3 vjecar.

Ky Akt i Themelimit te Shoqërisë Anonime përpilohet ne 3 kopje ne gjuhën Shqipe .

AKSIONERET THEMELUES

Bashkia Rrogozhine, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë,

Antonela DEDEJ

Antonela Dedej 

Shoqeria "Foglia Engineering" S.R.L , perfaqesuar me Prokure te Pergjithshme nga
Agim DEMROZI

Agim Demrozi 

Shoqeria "Demrozi Construzioni" S.R.L perfaqesuar me Prokure te Pergjithshme nga
Agim DEMROZI

Agim Demrozi 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER ALBAN GJOCI
ADRESA Nr.4,Bulevardi"Indrit
Cara",Pallati 5 katesh ,Kati 1,Kavaje
TEL: 0695148329

VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 1955

Kavaje më 21/08/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020014300083552482

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER ALBAN GJOCI

Nr. 1955 Rep

Date 21.08.2020



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 21.08.2020, para meje Noter ALBAN GJOCI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Kavaje, Nr.4, Bulevardi "Indrit Cara", Pallati 5 katesh, Kati 1, Kavaje, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Shoqëria "Foglia Engineering" s.r.l. përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e përgjithshme" me Nr. Rep 1151, Nr. kol 501, në datë 14/06/2020, nga Agim Demrozi, atësia Musa, amësia Hatije, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës, Durrës, Shqipëri (ALB) dhe banues në Kavajë, me adresë Blerimaj; Nd. 071; ; Luz I Vogël; Blerimaj; 2509; Kavajë, lindur më 03/07/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034192043 dhe nr. personal H10703034F.

NËNSHKRUES/IT:

Shoqëria "DEMROZI COSTRUZIONI" SRL përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e përgjithshme" me Nr. Rep 1151, Nr. kol 501, në datë 14/06/2020, nga Agim Demrozi, atësia Musa, amësia Hatije, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës, Durrës, Shqipëri (ALB) dhe banues në Kavajë, me adresë Blerimaj; Nd. 071; Luz I Vogël; Blerimaj; 2509; Kavajë, lindur më 03/07/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034192043 dhe nr. personal H10703034F.

NËNSHKRUES/IT:

Antonela Dedej, atësia Mustafa, amësia Hava, shtetas Shqiptar, lindur në Gosë, Shqipëri (ALB) dhe banues në Rogozhinë, me adresë Fermë Gosë; Nd. 063; H. 1; Ap. 0; Gosë; Gosë; 2508; Rogozhinë, lindur më 09/08/1992, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036054144 dhe nr. personal J25809042T, e cila vepron në këtë akt në cilësinë Kryetarit të bashkisë Rogozhinë.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noter, "Akt Themelimi", bashkëlidhur.

Unë Noter, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
ALBAN GJOCI

3800 / 7.11.2017



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT TIRANË

Nr. 6582 / Prot. 11

Tiranë, më 01/11/2017

Lënda: Verifikim Ligjshmërie

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Rrogozhinë

Bazuar në Ligjin nr.107/2016, dt. 27.10.2016, «Per Prefektin e Qarkut», dhe Ligjin nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 «Për vetëqeverisjen Vendore», Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e vendimeve nr. 55,56,57 dhe 58 dt. 20.10.2017, të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Pas verifikimit rezultoi se, vendimet nr. 55,56,57, dt. 20.10.2017, të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë janë marrë në përputhje me formën dhe procedurën e referencës ligjore të mësipërme, si dhe në përputhje me Ligjin nr.9355, dt.10.03.2005 «Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore», i ndryshuar.

Gjithashtu, edhe Vendimi nr. 58, dt. 20.10.2017, është në përputhje me formën dhe procedurën e referencës ligjore të mësipërme, si dhe në përputhje me Ligjin nr. 9901, dt.14.04.2008 «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare» i ndryshuar, për procedura të mëtejshme të kenë parasysh VKM nr. 1718, dt. 24.12.2008, «Për procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionere dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar».

PREFEKT

ADMIR ABRIJA





VENDIM
Nr. 58, datë 20.10.2017

PËR

**"TRANSFORMIMIN E EKIPIT TË FUTBOLLIT "EGNATIA" NË SHOQËRI AKSIONERE,
MIRATIMI I AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUTIT TË SHOQËRISË AKSIONERE
"KLUBI FUTBOLLIT EGNATIA"SHA"**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me dt. 20.10.2017 analizoi dhe diskutoi në laltje me projekt-vendimin e ardhur nga Bashkia, "Për transformimin e ekipit të futbollit "Egnatia" në Shoqëri Aksionere, miratimi i aktit të themelimit dhe statutit të Shoqërisë Aksionere "Klubi Futbollit Egnatia"SHA".

Mbështetur në ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 79/2017 "Për sportin", ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar); ligjin nr.9879, datë 21.02.2008 "Për titujt"; VKM-së nr.1718, datë 24.12.2008 për "Procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar"; Udhëzimit të përbashkët nr.8758/1 prot., datë 25.10.2010 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si dhe nr.7066 prot., datë 01.10.2010 të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për "Zbatimin e VKM-së nr.1718, datë 24.12.2008 për "Procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar", Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë "Klubi i Futbollit Egnatia" SHA., në kuadër të transformimit në shoqëri aksionere të Klubit të Futbollit Egnatia.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Klubi i Futbollit Egnatia.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARI
Lutfi KASHARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 22 , datë . 04 . 03. 2020

**PËR CAKTIMIN E NJË PREJ ZËVENDËSKRYETAREVE TË BASHKISË
RROGOZHINË , PËR KRYERJEN E FUNKSIONEVE TË KRYETARIT TË BASHKISË
, DERI NË ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË RI, PËR SHKAK TË NDARJES NGA
JETA TË KRYETARIT, HAXHI MEMOLLA**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës. 04. 03. 2020, analizoi dhe diskutoi
në lidhje me caktimin e një prej zëvendëskryetarëve të Bashkisë Rrogozhinë për kryerjen e
funksioneve të Kryetarit të Bashkisë, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri.*

Në mbështetje të nenit 8 , pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nenit 54, nenit 55
pika 6, nenit 61 "Përfundimi para kohe i mandatit të Kryetarit të Bashkisë", pika 1, gërma "e",
pika 5, të Ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , të Rregullores së
Këshillit Bashkiak . me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro. 1 (një) kundër 0 (zero) abstenim ,
Këshilli Bashkiak,

VENDOSI :

1. Caktimin e znj . **Antonela Dedej** për kryerjen e funksioneve të Kryetarit të Bashkisë, deri në
zgjedhjen e Kryetarit të ri, për shkak të përfundimit para kohe të mandatit të Kryetarit të
Bashkisë z. Haxhi Memolla i cili fatkeqësisht u nda nga jeta me datë , 22.02.2020.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Rrogozhinë

**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për
vetëqeverisjen vendore " dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë**

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADEN GIXHARI



Nn. 1645 prot

D 1.04.03-2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI QARKUT TIRANË
SEKTORI JURIDIK

PeP
Zbërthim
KAZ ESTARA
Jahollari

Nr. 489/1 Prot.

Tiranë, më 5.3.2020

Lënda: Verifikim ligjshmërie.

KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË

Bazuar në Ligjin nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" dhe Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e vendimit nr. 22, datë 04.03.2020 të Këshillit të Bashkisë Rrogozhinë.

Vendimi nr. 22, datë 04.03.2020 "Për caktimin e një prej zëvendëskryetarëve të Bashkisë Rrogozhinë, për kryerjen e funksioneve të Kryetarit të Bashkisë..." është në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 1; neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma b); neni 54; neni 55, pika 6; neni 61, pika 1, gërma e) dhe pika 5.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

SUZANA JAHOLLARI

